



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:282443  
Datë: 17.04.2024  
Numri i dokumentit: 05584867

Në çështjen juridike të:

AC-I-24-0139-A0001

*Paditësit/Ankuesit:*

- R S, nga fshati Ll, Lipjan
- A sh.p.k, S e M, , të dy të përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve P J.

Kundër:

*Të paditura:*

- Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë
- Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Prishtinë
- Agjencia Kadastrale e Kosovës, , Prishtinë
- Komuna e Lipjanit, Lipjan dhe
- F F T, R F T dhe B N T, të gjithë nga fshati G e U, Lipjan.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-23-0291, të datës 7 shkurt 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15 prill 2024, lëshon këtë:

## AKTVENDIM

- Ankesa e paditësve është e bazuar.

2. Ndryshohet Aktvendimi i Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III -23-0291 i datës 7 shkurt 2024.
3. Propozimi i paditësve për caktimin e masës së sigurisë, aprovet si i bazuar.
4. Detyrohen të paditurit që të mos e tjetërsojnë, shesin, fshijnë, ngarkojnë apo zhvillojnë ndërtime në njësinë kadastrale nr. ... në sipërfaqe prej 47936 m<sup>2</sup>. deri sa të vendoset në merita të padisë me një vendim gjyqësor të formës së prerë.
5. Një kopje e këtij Aktvendimi t'i dorëzohet Agjencisë Kadastrale të Kosovës në mënyrë që i njëjti të evidentohet në regjistrin kadastral.
6. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 15 dhjetor 2023, paditësit kishin paraqitur një padi për vërtetim të pronësisë dhe kompensim të dëmit me propozim për caktimin e masës së sigurimit. Në padi theksohej se blerësi A është zgjedhur si ofertues fitues për blerjen e tërë kapitalit të nxjerrë në aksion të kompanisë përmes një tenderi të hapur publik e në këtë rast edhe kjo parcelë e cila ka qenë në emër të ndërmarrjes N.SH “Poljoprivreda” dhe N.SH.K.B. “Kosova” Lipjan kishte kaluar në emër të A më saktësisht me datën 2 gusht 2010, Gjykata Komunale në Lipjan kishte marrë Aktvendim me nr. 42/08. Komuna e Lipjanit një pjesë të kësaj parcele pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë njoftim paraprak e kishte transferuar tek personat e tretë në kundërshtim me dispozitat e kësaj marrëveshje dhe Aktvendimin e lartcekur. E në këtë rast i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm paditësve pasi që të njëjtit janë pronar të vetëm legjitim të cilët e kanë fituar pronësinë në bazë të një ankandi publik të shpallur nga AKM dhe të regjistruar pronat të kësaj prone siç është shtjelluar në provën 1. Pra, Komuna e Lipjanit kishte bërë shkelje në këtë rast duke e transferuar pronën tek pala e tretë pasi që prona është në emër të R S i cili e kishte blerë nga A sh.p.k. ku e njëjta vërtetohet nga Certifikata ..së njësisë kadastrale P-....me sipërfaqe 47936 metër katror që është në emër të R S Në rastin konkret Komuna e Lipjanit do të duhej t'i zbatonte dispozitat ligjore të Ligjit të AKP-së sepse e njëjta ka qenë në dijeni se pronarët janë legjitimuar me kontrata të shitblerjes.

Paditësit theksojnë se në situatën faktike të treguar paditësve i është cenuar e drejta e pronësisë për pronën e cila është vërtetuar nga Certifikata ..të njësisë kadastrale P-... me sipërfaqe 47936

m2 që është në emër të R S si dhe Aktvendimi me nr.42/08 i datës 2 gusht 2010. Mirëpo Komuna e Lipjanit duke qenë në dijeni se pronarët janë legjitimuar me kontrata të shitblerjes kishte bërë shitjen/transferimin e pronës tek palët e treta. Andaj, paditësit i kishin propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve si e bazuar ndërsa të obligohet Drejtoria e Kadastrit në Lipjan ta bëj kthimin e gjendjes së mëparshme sipas gjendjes ekzistuese të parcelës P-...me sipërfaqe 47936 m2 ku pronarë legjitim të kësaj janë R S dhe A sh.p.k. Gjithashtu të detyrohet e paditura në mënyrë solidarë t'i kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën që do ta caktoj gjykata.

Në propozimin për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, paditësit theksojnë se të njëjtit në të gjitha format e kanë bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës mbi bazën ligjore, poashtu edhe në bazë të certifikatës ...të njësisë kadastrale P-... me sipërfaqe 47936 m2 që është në emër të R S si dhe në bazë të Aktvendimit nr. 42/08 të datës 2 gusht 2010 ku transferimi i ngastrës që është pronë e paditësve është bërë pa qenë të njoftuar ata dhe me këtë veprim është bërë i besueshëm ekzistimi i kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë. Nga pjesa e fakteve e treguar qartë nga paditësit/propozuesit e masës së sigurimit tregohet qartë se të paditurit kanë qenë në keqbesim nga fillimi ngase shitja/transferimi i njësisë kadastrale tek palët e treta është bërë pa njoftimin e të paditurve dhe në kundërshtim me Aktvendimin Nr.42/08 të datës 2 gusht 2010.

Andaj, propozuesit i kishin propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi propozimi për caktimin e masës së sigurimit ashtu që t'u ndalohej kundërshtarëve të masës së sigurimit AKP-së, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Komunës së Lipjanit dhe F R dhe B T ta tjetërsojnë, fshijnë, ngarkojnë, shesin, ndërtojnë njësinë kadastrale në fjalë.

Paditësit padisë dhe propozimit i kishin bashkëngjitur këto prova: autorizimin për përfaqësim, një Marrëveshje për Shitjen e Aksioneve të Rregullta në Kompaninë e re Llugagji Tokë Bujqësore sh.p.k nga dhe ndërmjet AKM-së që vepron si administrator për dhe në emër të N.SH "Poljoprivreda"/N.SH KB "Kosova", një aneks për kërkesën për ratifikim nga Bordi i AKM-së të Dokumentacionit të shitjes sa i përket shitjes së Kompanisë të re Llugagji Tokë Bujqësore sh.p.k, "A" sh.p.k, vendimi i aksionarëve gjatë takimit të përgjithshëm të aksionarëve të datës 8 qershor 2007, një Aktvendim të Gjykatës Komunale në Lipjan nr. 42/08 të datës 2 gusht 2010, skica për lëndën nr. 42/08, certifikatën e pronësisë, udhëzues juridik me nr. 38/2023 të datës 27 shkurt 2023, një Aktvendim të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me nr. 03/1934/23 të datës 24

tetor 2023, përgjigje e Komunës së Lipjanit e datës 10 nëntor 2023 me nr. 9-463/02-62428, një ankesë nga R S dhe A sh.p.k e datës 5 dhjetor 2023, një përgjigje sipas ankesës nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Me datë 22 dhjetor 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në padi në të cilën theksohet se ashtu sic është theksuar në padi lidhur me procedurën e udhëhequr nga përmbaruesi privat, AKP konsideron se kjo formë e ndryshimeve pronësore në regjistrat publik kadastral është realizuar në mënyrë të kundërligjshme pa i përfillur fare procedurat dhe dispozitat ligjore të kësaj fushe. Ekzekutimi i Aktgjykimit të viteve të 70-ta, pas më shumë se 50 vite nga e paditura e katërt kishte cenuar rëndë sigurinë juridike nga i cili lind dyshimi se ky organ fare nuk e kishte verifikuar qartë faktin apo e ka neglizhuar faktin e verifikimit të palëve në Aktgjykimin i cili kishte shërbyer për ndryshime kadastrale kur dihet qartë se Aktgjykimi në praktikë gjen zbatim vetëm ndaj palëve të cilët figurojnë në aktgjykim e asesi ndaj personave të tretë.

Tutje, e paditura thekson se kjo formë e zbatimit të ndërrimeve është padyshim e kundërligjshme edhe për faktin e pakontestueshëm sepse ende ekziston në fuqi kontrata e shitblerjes e lidhur në mes paditësit të parë Ai dhe të paditurës së parë AKM si dhe kontrata tjetër e shitblerjes e lidhur në mes të dy paditësve. Andaj, përderisa janë në fuqi të dy kontratat e shitblerjes e paditura e katërt në asnjë variant nuk ka mundur që të zbatoj ndryshimet në paluajtshmërinë lëndore në këtë çështje gjyqësore.

Në fund AKP kishte theksuar se të paditurës së parë i mungon legjitimacioni pasiv për të qenë palë në këtë procedurë dhe si përfundim gjykatës i kishte propozuar që pas administrimit të gjendjes faktike dhe shkresave të lëndës lidhur me kërkesëpadinë e paditësve në raport me të paditurin e parë të refuzohet si e pathemeltë ose si e pabazuar.

Gjithashtu po në të njëjtën datë, AKP-ja kishte paraqitur edhe përgjigje në propozimin për caktimin e masës së sigurisë në të cilën e njëjta i kishte përsëritur pretendimet e njëjta si në përgjigje në padi (si më lartë) duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të shkresave të lëndës të refuzoj propozimin për caktimin e masës së sigurimit si të pabazuar ose të pathemeltë.

Me datë 7 shkurt 2024, Kolegji i shkallës së parë të DHPGJS-së me Aktvendimin C-III-23-0291 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi theksohet se paditësit në këtë stad të procedurës nuk kishin dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tyre. Pretendimet e paditësve se pronën

kontestuese e kishin blerë në procedurë të privatizimit pastaj se e njëjta është bartur në eëmr të tyre bazuar në certifikatat e pronës të lëshuara nga Zyra Kadastrale e Komunës së Lipjanit nuk mund të merret si bazë për caktimin e masës së sigurimit.

Gjykata kishte vlerësuar se nuk është plotësuar as kushtin për dëm të menjëhershëm për caktimin e masës së sigurimit pasi që paditësi nuk e kishte paraqitur ndonjë rrethanë nga e cila pritet të pësoj ndonjë dëm të menjëhershëm dhe se nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit. Aq më tepër kur sipas mbrojtjes së AKP-së prona kontestuese i është shitur paditëses së dytë “A” sh.p.k në vitin 2007 me tender procedurë të privatizimit ndërsa lidhur me paditësin e parë R S të njëjtës i mungon legjitimiteti pasiv sepse nuk e ka krijuar ndonjë raport materialo-juridik me të. Gjithashtu e paditura Agjencia Kadastrale e Kosovës në përgjigjen ndaj urdhrin të gjykatës kishte shtuar se në rastin konkret nuk ka interes juridik që të ndaloj apo propozoj masë të sigurimit. Sipas vlerësimit të shkallës së parë dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar e në rastin konkret as kushti për dëm të pariparueshëm si kusht për tu caktuar masa e sigurimit nuk është plotësuar.

Me datë 20 shkurt 2024, paditësit R S dhe A sh.p.k. kishin paraqitur një ankesë ndaj Aktvendimit C-III-23-0291 të datës 7 shkurt 2024, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të aprovoj propozimin e propozuesve për caktimin e masës së sigurimit, ashtu që tu ndalohet kundërshtarëve të sigurimit tjetërsimi, fshirja, ngarkimi, zhvillimi i ndërtimeve dhe shitja e paluajtshmërisë-njësia kadastrale P... me sipërfaqe prej 47936 m2 në tërësi si të bazuar, duke anuluar Aktvendimin e ankimuar apo çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje. Në ankesë theksohet se Aktvendimi i ankimuar është i mangët dhe kontradiktor me vetveten, respektivisht arsyet dhe faktet vendimtare në të cilat thirret gjykata janë kundërthënëse në mes vete. propozuesit e masës së sigurimit kanë treguar qartë se kundërpropozuesit kanë qenë në keqbesim nga fillimi pasi që Komuna e Lipjanit një pjesë të kësaj parcele pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë njoftim paraprak e kishte transferuar tek personat e tretë në kundërshtim me dispozitat e kësaj marrëveshje dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan me numër 42/08. Mbi bazën e këtij fakti të pakontestueshëm dëmi është bërë i pariparueshëm dhe gjykata e paragjykon vullnetin e paditësve me arsyetimin se nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Paditësve në

rastin konkret iu është shkaktuar dëm i madh për shkak se kemi të bëjmë me cenimin e të drejtës së pronësisë për shkak se paditësit janë pronar legjitim të pronës së kontestuar dhe atë përmes një tenderi të hapur publik ku kjo parcelë e cila ka qenë në emër të N.SH “Poljoprivreda” N.SH KB “Kosova” kishte kaluar në emër të “A” sh.p.k me saktësisht me datë 2 gusht 2010 me Aktvendimin nr. 42/08 të Gjykatës Komunale në Lipjan. Në këtë çështje nuk ishin marrë parasysh fare veprimet e jashtëligjshme të Komunës së Lipjanit e cila ka bërë një shkelje të rëndë e që këto shkelje kanë cenuar të drejtat e propozuesit në shfrytëzimin e pronës së tij e blerë nëpërmjet rrugës ligjore. Propozuesve dëmi iu është shkaktuar nga kundërpropozuesit vetëm sepse e kanë të tjetërsuar/transferuar pasurinë tek pala e tretë e cila është vërtetuar me Aktvendimin nga e njëjta që është objekt i këtij shqyrtimi.

Me datë 29 shkurt 2024, ankesa e paditësve i është dorëzuar Ministrisë së Mjedisit.

Me datë 1 mars 2024, e njëjta i dorëzohet edhe Komunës së Lipjanit.

Ndërsa, të paditurve me numër rendor 5 u dorëzohet gjithashtu me datë 1 mars 2024.

Asnjëri nga këta deri më tani nuk ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës.

Me datë 4 mars 2024, AKP-ja kishte paraqitur një përgjigje në ankesë në të cilën i kishte propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësve ndërsa të vërtetohet Aktvendimin e ankimuar si të ligjshëm dhe të drejtë.

Me datë 6 mars 2024, Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) ishte përgjigjur në ankesën e paditësve në të cilën kishte theksuar se AKK për rastin konkret nuk ka interes juridik që të ndaloj apo të propozoj Masën e Sigurisë për palën në procedurë.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e paditësve është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të ndryshohet, dhe të aprovohet si i bazuar propozimi i paditësve për caktimin e masës së sigurisë.

Kriteret se kur duhet të lëshohet Masa e Sigurisë përcaktohen në nenin 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme i përmban që të dyja: fumus boni iuris (probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar presupozimi i bazës së mjaftueshme ligjore), dhe periculum in mora (rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së: cf., inter alia, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-0049, ASC-10-0088).

Me fjalë të tjera: Paditësi/Ankuesi i cili kërkon Masë të Sigurisë duhet të dëshmoj probabilitetin se 1) ekziston rreziku i të drejtës të cilën e kërkon, dhe 2) e drejta është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes ose dëmtimit të pariparueshëm, nëse nuk lëshohet Masa e Sigurisë e cila kërkohet.

Në këtë lëndë, Kolegji i Apelit vëren se paditësi nëpërmjet të tenderit të shpallur nga AKP-ja kishin blerë patundshmërinë në fjalë ngastrën kadastrale nr.P-...në sipërfaqe prej 47936 m<sup>2</sup>.

Pa ofertimit të suksesshëm paditësit dhe AKP-ja kishin nënshkruar Marrëveshje për Shitjen e Aksioneve të Rregullta në Kompaninë e re Llugagji Tokë Bujqësore sh.p.k nga dhe ndërmjet AKM-së që vepron si administrator për dhe në emër të N.SH “Poljoprivreda”/N.SH KB “Kosova”, një aneks për kërkesën për ratifikim nga Bordi i AKM-së të Dokumentacionit të shitjes sa i përket shitjes së Kompanisë të re Llugagji Tokë Bujqësore sh.p.k, “A” sh.p.k. dhe patundshmëria në fjalë ishte evidentuar në regjistra kadastral në emër të paditësve në vitin 2010.

Në mbështetje të këtyre pretendimeve paditësit kanë dorëzuar këto prova, autorizimin për përfaqësim, një Marrëveshje për Shitjen e Aksioneve të Rregullta në Kompaninë e re Ll Tokë Bujqësore sh.p.k nga dhe ndërmjet AKM-së që vepron si administrator për dhe në emër të N.SH

“Poljoprivreda”/N.SH KB “Kosova”nr. 860/2007 të datës 08 qershor 2007, një aneks për kërkesën për ratifikim nga Bordi i AKM-së të Dokumentacionit të shitjes sa i përket shitjes së Kompanisë të re Ll Tokë Bujqësore sh.p.k, “A” sh.p.k, vendimi i aksionarëve gjatë takimit të përgjithshëm të aksionarëve të datës 8 qershor 2007, një Aktvendim të Gjykatës Komunale në Lipjan nr. 42/08 të datës 2 gusht 2010, skica për lëndën nr. 42/08, certifikatën e pronësisë, udhëzues juridik me nr. 38/2023 të datës 27 shkurt 2023, një Aktvendim të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me nr. 03/1934/23 të datës 24 tetor 2023, përgjigje e Komunës së Lipjanit e datës 10 nëntor 2023 me nr. 9-463/02-62428, një ankesë nga R S dhe A sh.p.k e datës 5 dhjetor 2023, një përgjigje sipas ankesës nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji i Apelit vëren se me marrëveshjen për shitjen e aksioneve të datës 08 qershor 2007 tek blerësi transferohet patundshmërisë në fjalë.

Gjithashtu, Kolegji i Apelit vëren se gjithashtu me Aktvendimin numër 1056/2018 i datës 15 tetor 2018, patundshmëria kontestuese kalon në emër të së paditurve me numër rendor 5.

Kolegji i Apelit konstaton se deri në këtë fazë të procedurës paditësit kanë dorëzuar prova të mjaftuara që vërtetojnë se ajo ka një shkallë të probabilitetit që të del e suksesshme në meritat të padisë.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit nuk mund ta mbështesë konstatimin e Kolegjit të Shkallës së parë, se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 61.1 të LDHP që të caktohet masa e sigurisë.

Për më tepër paditësit pretendojnë se shitja apo kalimi i kësaj patundshmërie tek personat e tretë do të shkakton pasoja me dëm të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm për ta.

Për më tepër edhe AKP-ja i pranoj të gjitha pretendimet e paditësve duke kërkuar nga Gjykatat caktimin e masës së Sigurisë

Kolegji i Apelit konstaton se në këtë rast është e nevojshme të mbrohet prona kontestuese në fjalë nga shitja eventuale e të paditurve tek personat e tretë dhe atë derisa të vendoset në merita të padisë, duke i ndaluar të paditurit dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës që t’i tjetërsojë, shesë apo të ndër marrë çfarëdo veprimi tjetër ndaj patundshmërisë në fjalë, ngastrës kadastrale nr.P-...në sipërfaqe prej 47936 m2.



Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësve është e bazuar, andaj ndryshohet Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të shkallës së parë, dhe aprovohet propozimi i paditësve për caktimin e masës së sigurisë si i bazuar.

Kolegji i Apelit këshillon Kolegjin e shkallës së parë që gjatë shqyrtimit të padisë së pari të trajtoj juridiksionin e DHPGJS-së për çështjen në fjalë.

Ky Aktvendim në asnjë mënyrë nuk prejudikon zgjidhjen e meritave të padisë.

Nga sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 26 shkurt 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 15 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_

Numri i lëndës: 2023:282443  
Datë: 17.04.2024  
Numri i dokumentit: 05584867